

VENDIM
Nr.279, datë 7.4.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.23, DATË 20.1.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E AGJENCISË KOMBËTARE BËRTHAMORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.23, datë 20.1.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 1 fjalët “...në varësi të Kryeministrit...” zëvendësohen me “...në varësi të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

2. Në pikën 7 fjalët “... me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...” zëvendësohen me “...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

3. Në pikën 8 fjalët “...me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...” zëvendësohen me “...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

4. Në pikën 9 fjalët “...me propozimin e sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave...” zëvendësohen me “...me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

5. Në pikën 10 fjalët “... Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin...” zëvendësohen me “... Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha